

VENDIM
Nr. 304, datë 9.5.2012

**PËR PËRBËRJEN DHE DETYRAT E KOMISIONEVE TË REGJISTRIMIT TË
PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE EKONOMIKE BUJQËSORE NË BASHKI DHE KOMUNA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d” të nenit 12 të ligjit nr. 10201 datë 17.12.2009 “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Përbërja e komisioneve të regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore në bashki/komuna

1. Komisioni i regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore në bashki kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga këta anëtarë:

- i) Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile;
- ii) Drejtori (përgjegjësi) i zyrës së shërbimeve sociale;
- iii) Përgjegjësi i zyrës së urbanistikës;
- iv) Një përfaqësues i INSTAT-it.

2. Komisioni i regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore në komunë kryesohet nga kryetari i komunës dhe përbëhet nga këta anëtarë:

- i) Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile;
- ii) Drejtori (përgjegjësi) i zyrës së shërbimeve sociale;
- iii) Përgjegjësi i zyrës së urbanistikës;
- iv) Një përfaqësues i INSTAT-it.

II. Detyrat e komisionit të regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore në bashki/komuna

Në zbatim të detyrimeve ligjore, të përcaktuara në ligjin nr. 10 201, datë 17.12.2009 “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore” të nenit 12, shkronja “d” dhe udhëzimeve të Institutit të Statistikave (INSTAT), komisioni i regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore në bashki e komuna, ushtron detyrat e mëposhtme:

1. Miraton programin e punës së komisionit të regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore të bashkisë/komunës, si për fazën përgatitore, ashtu dhe për atë përfundimtare;

2. Emëron anketuesit e përzgjedhur në bazë të kriterëve të kualifikimit, të hartuara nga INSTAT-i;

3. Organizon punën për trajnimin e anketuesve (siguron ambientet për trajnimin dhe të gjitha mjetet e tjera të nevojshme logjistike);

4. Organizon punën për ofrimin e asistencës teknike për anketuesit, nëpërmjet ekspertëve dhe profesionistëve të tjerë të INSTAT-it, në përputhje me vlerësimet në terren dhe nevojat e paraqitura prej tyre;

5. Organizon inspektime periodike, në bashkëpunim me kontrollorët, gjatë procesit të anketimit dhe ndjek në vazhdimësi, nëpërmjet mbikëqyrësve dhe kontrollorëve, mbarëvajtjen dhe cilësinë e regjistrimit, me qëllim plotësimin e standardeve të përcaktuara nga legjislacioni, si dhe metodologjitë e udhëzimet e INSTAT-it për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore;

6. Raporton pranë komisionit të regjistrimit në qark dhe në INSTAT lidhur me ecurinë e procesit të regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore;

- a) një herë në javë, gjatë periudhës përgatitore; dhe
- b) çdo ditë, në periudhën e regjistrimit.

7. Organizon punën në bashkëpunim me punonjës të INSTAT-it, në nivel bashkie/komune, dhe me komisionin e regjistrimit në qark për sigurimin e mjediseve të nevojshme e të përshtatshme, marrjen

në dorëzim dhe magazinimin e pyetësorëve e të materialeve të tjera shoqëruese, në mënyrë të sigurt dhe për aq kohë sa është e nevojshme për procesin e regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike, bujqësore në të gjithë territorin e njësisë vendore;

8. Siguron ambientet e nevojshme për koordinimin e punës ndërmjet anketuesve, kontrollorëve e mbikëqyrësve për të realizuar plotësimin me cilësi të anketave dhe zgjidhjen e problemeve të tjera që lindin gjatë procesit të regjistrimit në terren;

9. Organizon procesin e ruajtjes dhe të dorëzimit të materialeve të regjistrimit në afatin e përcaktuar nga INSTAT-i.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha